

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. EUGEN BECI

06/26/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 24.06.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Eugen Beci bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 26.06.2019, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Eugen Beci, prokuror i Prokurorisë pranë Gykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Valbona Sanxhaktari, znj. Xhensila Pine relatores, z. Roland Ilia anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.